

Zonjasim
of Beve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

AMENDAMENT

KUVENDI

NR 495 DATE 08.02.24

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR DHËNIE AMNISTIE”

Në mbështetje të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës, dhe nenit 71, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputeti Z. Bledion Nallbati propozon,

Në projektligjin “Për Dhënie Amnistie”, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 3, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, numri “3” të zëvëndësohet me numrin “4”.

Neni 2

Në nenin 4, pika 1, shkronja “k”, togfjalëshi “...në paragrafin e dytë dhe të katërt të nenit 245/1...”, të hiqet.

Neni 3

Në nenin 6, pika 1, togfjalëshi “...në paragrafin e parë dhe të tretë të nenit 245/1...”, të hiqet.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR DHËNIE AMNISTIE”

Sipas edhe relacionit të paraqitur nga Këshilli i Ministrave, projektligji për dhënien e amnistisë ka si qëllim trajtimin njerëzor dhe respektimin e dinjitetit të individit, riintegrimin dhe rehabilitimin social të personave të dënuar dhe të atyre që janë duke u ndjekur penalisht për vepra penale të lehta. Nga ana tjetër, po ashtu, që duke pasur në konsideratë parimin e humanizmit, projektligji ka propozuar që në rastet e veprave tepër të lehta penale vlerësohet se është më e përshtatshme të shuhet ndjekja penale, procedimi penal apo gjykimi, pasi trezikshmëria e veprës penale dhe trezikshmëria e autorit nuk diktojnë nevojën për të aplikuar dënimet me burgim apo dënimet të tjera më të lehta.

Megjithatë, pavarësisht parimeve të mësipërme, projektligji ka bërë në trajtim të diferencuar, të papërligjur, ndërmjet të dënuarve femra dhe meshkuj. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 18 të tij, ka përeaktuar që të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, seje, etnic, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa paragrafi i tretë, mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit, askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive. Gjykata Kushtetuese ka një jurisprudencë të zhvilluar në drejtim të interpretimit të nenit 18 të Kushtetutës, duke arsyetuar që “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë

nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.34, datë 20.12.2005; nr.39, datë 16.10.2007; nr.4, datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Jurisprudanca e gjykatës kushtetuese ka detyruar organin ligjvënës që t'i përbahet këtij parimi kushtetuese, duke pasur në konsideratë nevojën për të arsyetuar në çdo rast, që trajtimi i diferencajve i subjekteve të jetë i përligjur dhe për një arsyeshëm objektive. Kjo përligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferençimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm.

Në këtë drejtim, Këshilli i Ministrave nuk ka arsyetuar mjaftueshëm trajtimin e diferencajve që bëhet ndërmjet kritereve përfitimin nga amnistia ndërmjet meshkujve dhe femrave dhe shkaqet pse ky trajtim i diferencajve mund të ishte i përligjur. Në vlerësimin e deputetit propozues, mund të ishte një trajtim i diferencajve i përligjur, në rastet e femrave me fëmijë të mitur, kjo duke pasur në konsideratë, interesin më të lartë të fëmijës, dhe nevojën për lidhjen emocionale ndërmjet fëmijës së mitur dhe kujdesit të shtuar që nëna mund të ketë ndaj fëmijës në këto raste. Ky lloj diferençimi i përligjur njihet edhe nga Kodi i Familjes dhe mund të plotëson standardin kushtetues të vendosur nga nen 18 i Kushtetutës. Nga ana tjetër, nuk ka asnjë shkak për të pasur një trajtim të ndryshëm ndërmjet një mashkulli dhe një femre, që mund të ishin në kushte të njëjtë, pra në moshë të njëjtë, dhe pa fëmijë në ngarkim. Në drejtim të legjislacionit penal, trajtimi i këtyre shtetasve, vetëm duke u bazuar në gjininë e tyre, duhet të ishte i njëjtë. Për këtë qëllim, propozohet që edhe për personat meshkuj, të përjashtohen nga vuajtja e dënimit, me të njëjtat kriterë siç edhe përjashtohen personat femra.

Nga ana tjetër, në analizën e veprave penale që amnistohen ose jo nga projektligji, duket qartë që një nga kriteret përzgjedhëse ka qenë masa e dënimit për vepra penale të caktuar. Pra, praktikisht, bazuar nga rrezikshmëria e veprës penale, Këshilli i Ministrave ka vendosur të propozojë amnistimin ose jo të një vepre të caktuar. Elementi kryesor që dallon rrezikshmërinë e veprave penale, dhe kuptimin e ligjvënësit për rrezikshmërinë e tyre është masa e dënimit. Në propozimin e Këshillit të Ministrave, në raste të caktuara, qartësisht ky kriter nuk është zbatuar në mënyrë uniforme. Përkatësisht, në rastet e personave të dënuar, sipas nenit 245/1, paragrafi

i dytë dhe i katërt, pavarësisht se dënohen nën minimumin e përcaktuar nga kriteri i përfitimit, sipas nenit 3 (4 vite), përsëri, në këto raste, vepra, edhe pse ka një rezikshmëri të ulët, është vendosur si kriter ndalues. Akoma më problematike është kjo çështje, po të kihet në konsideratë që në rastet e ushtrimit të ndjekjes penale, të parashikuar nga neni 6, të projektligjit, pavarësisht se paragrafi i parë dhe i tretë dënohen me respektivisht, në maksimum, me 1 dhe 2 vjet, përsëri kjo vepër është vendosur si kriter ndalues. Duke pasur në konsideratë arsyetimin sa më sipër, propozohet që kjo çështje të ndryshohet sipas propozimit të këtij amendamenti.

DEPUTETI

Bledion NALIBATI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "BLEDION NALIBATI". The signature is fluid and cursive, with some loops and variations in line thickness.